

- Gjithmonë kur është e mundur të blejmë dhe përdorim ngjyra në bazë ujore ose pa tretës, përkatësisht prodhime me përmbajtje të ulët të përbërjeve të avullueshme organike (low VOC).
- Të riciklojmë dhe të ripërdorim, kjo e zvogëlon varësinë prej prodhimit të re dhe harxhimit të energjisë dhe lëndëve të papërpunuara për atë dedikim.
- Të blejmë dhe përdorim koftorë me efikasitet energjetik, ato në mënyrë efektive e shfrytëzojnë energjinë që e përmbajnë lëndët djegëse dhe në minimum e ndotin rrethinën.
- Të blejmë dhe të përdorim sisteme të cilat përdorin burime të energjisë që ripërtërihen siç janë: sistemet termale diellore për ngrohje të ujit sanitar, sistemeve diellore për prodhimtarinë të energjisë elektrike (sisteme fotovoltaike) për nevojat e ekonomisë shtëpiake, koftorë që djegin biomasë (peleta, çips).



Për më tepër këshilla për të drejtat tuaja si konsumatorë, mund të kontaktoni Organizatën e Konsumatorëve të Maqedonisë, ZKM - Shkup, tel. 02/3 179 592 ose nëpërmjet faqes së internetit [www.opm.org.mk](http://www.opm.org.mk) e-mail: [sovetuvanja@opm.org.mk](mailto:sovetuvanja@opm.org.mk)

**KËSHILLI PËR MBROJTJE TË KONSUMATORËVE I QYTETIT TË SHKUPIT ME PROGRAMIN E VET E MBËSHTET MBROJTJEN E KONSUMATORËVE**

Qyteti i Shkupit



COBET ЗА ЗАШТИТА  
НА ПОТРОШУВАЧИТЕ

**KËSHILLI PËR MBROJTJE TË KONSUMATORËVE I QYTETIT TË SHKUPIT**  
Bul. Ilinden nr. 82 - Shkup

OTM



Qyteti i Shkupit



COBET ЗА ЗАШТИТА  
НА ПОТРОШУВАЧИТЕ

**KONSUMATORË  
TA ULM  
NDOTJEN  
E AJRIT!**

## Çka donë të thotë ndotja e ajrit?

Ndotja e ajrit ndodh kur në atmosferë çlirohen gazra, grimca pluhuri, tym ose aroma që janë të dëmshme për njerëzit, kafshët dhe bimët. Ashtu ajri e humb pastërtinë (kontaminohet ose ndotet). Materiet që e ndotin ajrin quhen ndotës. Ndotës më të shpeshtë janë: oksidet e azotit, karbon monoksidi dhe dyoksidi, hidrokarburet, oksidet e sulfurit, plumbi, ozoni në nivel të tokës, grimcat prej rëre ose pluhurit dhe përbërjet organike të cilat mund të avullohen dhe të hyjnë në atmosferë.



## Pse ndotja e ajrit paraqet problem?

Ndotja e ajrit ndikon mbi shëndetin tonë. Thithja e substancave të rrezikshme kimike sikur benzeni ose vinil kloridi në ajër shkaktojnë kancer, defekte gjatë lindjes, dëmtim të mushkërive, trurit dhe nervave, ndërkaq në disa raste madje mund të shkaktojnë edhe vdekje. Thithja e ajrit të kontaminuar mund t'i irritojë sytë dhe hundën dhe të shkaktojë probleme me frymëmarrjen, veçanërisht për personat astmatik. Ndotja e ajrit ndikon në mjedisin jetësor. Kontaminuesit toksik në ajër mund të formojnë reshje shiu acidik ose mund të formohet ozon në nivel të tokës. Ato i shkatërrojnë drunjtë, kulturat, feramat, kafshët ndërsa resurset ujore i bëjnë të dëmshme për njerëzit dhe kafshët që jetojnë dhe janë të varura nga uji.

Karbon dyoksidi dhe metani kontribuojnë më së shumti për krijimin e efektit të serës që në anën tjetër është shkaktar i ngrohjes globale.

Ndotja e ajrit tërthorazi ndikon në ekonomi. Ekonomia përparon kur njerëzit janë të shëndoshë, ndërsa sektori afarist që varet prej lëndëve të para të kultivuara dhe resurseve njerëzore funksionon me efikasitet të plotë. Ndotja e ajrit i dobëson rendimentet e kulturave bujqësore dhe pyjeve komerciale, për çdo vit gjithnjë e më tepër. Kjo, krahas faktit që ka ndikim negativ mbi shëndetin e njerëzve që punojnë në vende të hapura mund t'i kushtojë shumë ekonomisë.

## Çka e shkakton ndotjen e ajrit?

Ndotja e ajrit mund të rezultojë prej aktiviteteve të njerëzve dhe natyrës. Ndodhitë natyrore që ndotin ajrin përfshijnë zjarret pyjore, erupsionet vullkanike, erozionet prej frymës, përhapjen e polenit, avullimit të përbërjeve organike dhe radioaktivitetit natyral. Ndotja prej dukurive natyrore nuk është shumë e shpeshtë. Aktivitetet e njerëzve që rezultojnë me ndotjen e ajrit përfshijnë:

### 1. Emisionet prej industrive dhe prodhimitarisë



## 2. Djegies së derivateve fosilike

(energjenja, transport, ngrohjet e hapësirave të mbyllura)



## 3. Substanca kimike të cilat përdoren në ekonomi shtëpiake dhe ferma

*Çka mund të bëjmë si konsumatorë për ta zvogëluar ndotjen e ajrit?*

- Të blejmë dhe të përdorim poçe me efikasitet energjetik dhe teknike të bardhë.
- Të kursejmë energji - të mos i harrojmë ndezur dritat, kompjuterët dhe aparatet elektrike kur nuk nevojiten të përdoren.
- Të përdorim transport publik, biçikleta dhe të ecim në vend se të përdorim automjetin.
- Të shmangim transportin personal në automjet të zbrazët.
- Rregullisht ta mirëmbajmë dhe të bëjmë servisimin e automjetit (ndërrim të vajit, filtrit, presionin në goma) për të mundësuar konsum minimal të karburantit.
- Të jemi të vëmendshëm gjatë mbushjes së automjetit me naftë ose pajisjeve kopshtare të mos derdhet lënda djegëse, përkatësisht të shmangjet avullimi në rrethinën.
- Të mbushim naftë gjatë natës, kur është më e freskët, për të shmangur avullimin në rrethinën.
- Të blejmë dhe të përdorim kositëse elektrike ose manuale dhe aparate për mirëmbajtjen e oborreve/kopshteve.
- Të blejmë dhe të përdorim produkte ekologjike për pastrim.